



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 26

2003

Prill

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Dekret nr.3724/1 datë 5.3.2003	Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare.....	831
Vendim i Kuvendit nr.74, datë 7.4.2003	Për përbërjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit, ngritur me vendimin nr.72, datë 17.3.2003.....	832
Vendim i KM nr.212, datë 28.3.2003	Për një ndryshim në vendimin nr.555, datë 2.12.1999 të Këshillit të Ministrave “Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimi i superstradës Vorë-Mamias, pjesë e superstradës Tiranë-Durrës”.....	833
Vendim i KM nr.217, datë 10.4.2003	Për rritjen e masës së shpërblimit të veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar.....	835
Vendim i KM nr.218, datë 10.4.2003	Për kalimin në administrim të bashkisë së qytetit Përmet të ish-shtëpisë së ushtarakëve në këtë qytet.....	836
Vendim i KM nr.219, datë 10.4.2003	Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të punonjësve civilë, me arsim të lartë, në spitalin ushtarak qendror universitar dhe për trajtimin e mjekëve në strukturat e forcave të armatosura.....	837

Vendim i KM nr.220, datë 10.4.2003	Për një shtesë në vendimin nr.439, datë 4.8.2000 të Këshillit të Ministrave “Për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.....	838
Vendim i KM nr.221, datë 10.4.2003	Për disa ndryshime në vendimin nr.671, datë 15.12.2000 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e komisionit të përcaktimit të verbërisë”.....	838
Vendim i GJK nr.12, datë 9.4.2003	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr.259, datë 6.7.2001 të Gjykatës së Apelit Korçë dhe nr.940, datë 18.9.2002 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si antikushtetuese.....	839
Vendim i GJK nr.14, datë 15.4.2003	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr.1626, datë 28.12.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; nr.333, datë 21.6.2001 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe nr.717, datë 4.7.2002 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si antikushtetuese.....	841
Vendim i GJK nr.15, datë 17.4.2003	Me objekt shfuqizimin e nenit 410/2 të ligjit nr.7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë” ndryshuar me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002, si antikushtetues.	844

D E K R E T
Nr.3724/1, datë 5.3.2003

PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

D E K R E T O J:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- | | |
|--|-----------------------------------|
| 1.Arben Xhevit Ismailaj | 34.Eduard Haxhi Kasnija |
| 2.Manjola Sabri Tahiri-Czech (Sulejmani) | 35.Nelson Murat Toptani |
| 3.Jonas Tobias Arben Tahiri-Czech | 36.Agron Avni Turhani |
| 4.Nexhmije Dule Meminaj | 37.Ivna Agron Turhani |
| 5.Eltjon Vladimir Bregu | 38. Joe Agron Turhani |
| 6.Miqail Elmaz Hoxha | 39.Ermira Ramiz Turhani (Mebelli) |
| 7.Nevrus Sadik Bellsiku | 40.Donalda Agron Turhani |
| 8.Nikoll Mark Celaj | 41.Maksim Filip Peja |
| 9.Mark Nikoll Celaj | 42.Elena Maksim Peja |
| 10.Martin Nikoll Celaj | 43.Suzana Behxhet Peja (Kamberi) |
| 11.Dorina Nikoll Celaj | 44. Seit Sulo Seiti |
| 12.Ana Llesh Celaj (Turkaj) | 45. Marika Nako Seiti (Gjokthomi) |
| 13.Nikoll Spiro Bufi | 46.Edison Seit Seiti |
| 14.Christian (Kristian) Nikoll Bufi | 47.Erida Seit Seiti |
| 15.Rovena Besnik Bufi (Gercaliu) | 48. Gent Çapajev Shalari |
| 16. Behije Ahmet Rotthoff (Veizi) | 49.Saimir Gani Karaj |
| 17.Klaus Qemal Maçi | 50. Agron Belul Mehmeti |
| 18. Alda Qemal Maçi | 51.Hyrije Malo Cakaj |
| 19.Agim Vaid Budo | 52.Frank Petrit Cakaj |
| 20.Kristina Dylber Maly (Bixhaku) | 53.Roland Nasi Stefa |
| 21.Zhaneta Jorgji Schutz – Misho | 54.Mirjam Ruzhdi Tola |
| 22.Flutura Enver Azizi (Lama) | 55.Arjana Trifon Serbin (Shyti) |
| 23.Osman Ramazan Luli | 56.Hane Hasan Nallbani (Axha) |
| 24.Ardit Vladimir Bregu | 57.Hajdar Engjëllush Gremi |
| 25.Niko Leonidha Manushi | 58.Terenca Hajdar Gremi |
| 26.Luljeta Jashar Manushi (Gabaj) | 59.Lorena Hajdar Gremi |
| 27.Migena Niko Manushi | 60.Alma Kristaq Gremi (Pojanaku) |
| 28.Gazmend Zaho Balili | 61.Agron Bani Duka |
| 29.Agim Jonus Gjoka | 62.Klaudio Agron Duka |
| 30.Greta Agim Gjoka | 63.Pamela Agron Duka |
| 31.Jonida Agim Gjoka | 64.Ariana Xhevat Duka (Kodheli) |
| 32.Skerdi Tefik Guri | 65.Bujar Iljas Spahiu |
| 33.Agron Qazim Canaj | |

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

V E N D I M
Nr.74, datë 7.4.2003

PËR PËRBËRJEN E KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT,
NGRITUR ME VENDIMIN NR.72, DATË 17.3.2003

Në mbështetje të nenit 77 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit” dhe të vendimit të Kuvendit nr.72, datë 17.3.2003,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Përbërja e Komisionit Hetimor të Kuvendit, ngritur me vendimin nr.72, datë 17.3.2003 “Për ngritjen e Komisionit hetimor të Kuvendit për hetimin e veprimtarisë së qeverisë për transparencën e procesit të firmave piramidale në bazë të ligjit nr.8215, datë 9.5.1997 “Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë””, të jetë si më poshtë:

1. Arben Imami- Kryetar
2. Limoz DizdariZëvendëskryetar
3. Durim HushiAnëtar
4. Zyhdi PepaAnëtar
5. Ejup TabakuAnëtar
6. Bashkim FinoAnëtar
7. Flamur HoxhaAnëtar
8. Besnik MustafajAnëtar
9. Preç ZogajAnëtar
10. Pal DajçiAnëtar
11. Sajmir CurriAnëtar

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I
Servet Pëllumbi

V E N D I M
Nr.212, datë 28.3.2003

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.555, DATË 2.12.1999 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SUPERSTRADËS
VORË-MAMINAS, PJESË E SUPERSTRADËS TIRANË-DURRËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Në vendimin nr.555, datë 2.12.1999 të Këshillit të Ministrave, të bëhet ky ndryshim:
 - Në numrin rendor 44 të tabelës që i bashkëlidhet listës emërore të pronarëve, të cilët shpronësohen, në shënimin konflikt, të bëhet ndryshimi sipas emrave të pronarëve dhe masës përkatëse që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për një sipërfaqe të përgjithshme 24111,53 m2 tokë/arë, në shumën e përgjithshme prej 26 522 684 (njëzet e gjashtë milionë e pesëqind e njëzet e dy mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e katër) lekësh.
 2. Ngarkohet Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

REPUBLIKA E SHQIPERISE

QARKU TIRANE

Fshati : Marikaj

Lista e pronarëve që shpronësohen për efekt të ndërtimit të superstradës

Vore-Sukth (Fshati Marikaj)

Lloji i pasurisë se paluajtshme : Toke bujqesore Nr 1-44

Nr	Emri	Atesia	Mbiemri	Kilometra zhi	Adresa e Pasurise	Nr/pasurise	Lloji i pasurise	PERMASAT		Sip (m2)	Cmimi lek/m2	Vlera (Lek)	Shenime
								Gjat (m)	Gjer (m)				
1	Sabike Albert Dashamir	Hasan Qemal Qemal	Bylyku Bylyku Bylyku	6 + 955	Marikaj	266/1	are	53	12.2	646.6	1100	711260	Bashkepronar
2	Reshit	Selman	Mariku	6+830	Marikaj	266/18	are	53	6.25	331.25	1100	364375	
3	Mustafa	Haxhi	Bylyku	6+945	Marikaj	266/2	are	53	6.06	321.18	1100	353298	
4	Shkelqim	Mustafa	Bylyku	6+935	Marikaj	266/3	are	53	6.05	320.65	1100	352715	
5	Pa identifikuar			6+930	Marikaj	266/4	are	53	6.13	324.89	1100	357379	
6	Petrit	Mehmet	Bylyku	6+923	Marikaj	266/5	are	52.8	6.13	323.664	1100	356030.4	
7	Zyhdi	Muhamet	Bylyku	6+913	Marikaj	266/6	are	52.6	6.25	328.75	1100	361625	
8	Ramazan	Muhamet	Bylyku	6+905	Marikaj	266/7	are	52	6.25	325	1100	357500	

9	Agim	Haxhi	Bylyku	6+898	Marikaj	266/8	are	51.5	6.25	321.875	1100	354062.5	
10	Abdulla	Shaban	Bylyku	6+888	Marikaj	266/9	are	51.5	6.25	321.875	1100	354062.5	
11	Pa identifikuar			6+885	Marikaj	266/10	are	50.5	3.12	157.56	1100	173316	
12	Ali	Ramazan	Bylyku	6+883	Marikaj	266/11	are	50	12.65	632.5	1100	695750	
13	Pa identifikuar			6+873	Marikaj	266/12	are	49	3.16	154.84	1100	170324	
14	Mersin	Ibrahim	Subashi	6+870	Marikaj	266/14	are	50	3.18	159	1100	174900	
15	Pa identifikuar			6+860	Marikaj	266/15	are	47.5	6.37	302.575	1100	332832.5	
16	Ahmet	Ibrahim	Subashi	6+865	Marikaj	266/13	are	49	3.16	154.84	1100	170324	
17	Hysni	Shyqyri	Bylyku	6+850	Marikaj	266/16	are	47	6.37	299.39	1100	329329	
18	Bujar	Xhaferr	Bylyku	6+838	Marikaj	266/17	are	47	6.37	299.39	1100	329329	
19	Gezim	Emin	Mariku	6+825	Marikaj	266/19	are	45	6.58	296.1	1100	325710	
20	Nazmi	Osman	Subashi	6+821	Marikaj	266/20	are	44.6	3.3	147.18	1100	161898	
21	Kujtim	Osman	Subashi	6+818	Marikaj	266/21	are	44.5	3.33	148.185	1100	163003.5	
22	Tahir	Qazim	Subashi	6+816	Marikaj	266/22	are	44.4	3.33	147.852	1100	162637.2	
23	Sulejman	Qazim	Subashi	6+814	Marikaj	266/23	are	44.3	3.33	147.519	1100	162270.9	
24	Zydi	Qazim	Subashi	6+812	Marikaj	266/24	are	44.2	3.38	149.396	1100	164335.6	
25	Sami	Zenel	Subashi	6+805	Marikaj	266/25	are	44.1	3.45	152.145	1100	167359.5	
26	Zenel	Ibrahim	Subashi	6+802	Marikaj	266/26	are	44	3.45	151.8	1100	166980	
27	Bedri	Qamil	Bylyku	6+790	Marikaj	266/28	are	42	7.5	315	1100	346500	
28	Shpetim	Qamil	Bylyku	6+798	Marikaj	266/27	are	42	6.9	289.8	1100	318780	
29	Fadil	Ramazan	Subashi	6+670	Marikaj	267/2	are	38	16.66	633.08	1100	696388	
30	Ylli	Fadil	Subashi	6+648	Marikaj	267/3	are	37	16.95	627.15	1100	689865	
31	Baki	Ramazan	Bylyku	6+723	Marikaj	267/6	are	39	45.28	1765.92	1100	1942512	
32	Pellumb	Jonuz	Bylyku	6+688	Marikaj	267/7	are	39	24	936	1100	1029600	
33	Seit	Ramazan	Subashi	6+623	Marikaj	267/8	are	36	26.5	954	1100	1049400	
34	Agim	Seid	Subashi	6+580	Marikaj	267/9	are	35	53	1855	1100	2040500	
35	Beqir	Muhamet	Bylyku	6+543	Marikaj	268/1	are	34.5	20	690	1100	759000	
36	Rifat	Muhamet	Bylyku	6+517	Marikaj	268/2	are	34	40	1360	1100	1496000	
37	Mehmet	Hasan	Bylyku	6+473	Marikaj	268/3	are	34	36.1	1227.4	1100	1350140	
38	Asllan	Hasan	Bylyku	6+448	Marikaj	268/4	are	34.5	30.77	1061.565	1100	1167721.5	
39	Kujtim	Besim	Bylyku	6+325	Marikaj	268/7	are	35	20.83	729.05	1100	801955	
40	Sherif	Besim	Bylyku	6+348	Marikaj	268/6	are	34	20.04	681.36	1100	749496	
41	Xheladin	Muharrem	Bylyku	6+365	Marikaj	268/8	are	34	30.92	1051.28	1100	1156408	
42	Hysni	Xheladin	Bylyku	6+390	Marikaj	268/9	are	34	20.5	697	1100	766700	
43	Sulejman		Bylyku	6+765	Marikaj	267/5	are	41	35.7	1463.7	1100	1610070	
44	Arian	Xheladin	Bylyku	6+370	Marikaj	268/10	are	34	20.83	708.22	1100	779042	

Shuma :

1927.5 614.83 24111.531

26522684.1

Mbyllet me numer rendor 44 (dyzetekater)

V E N D I M

Nr.217, datë 10.4.2003

PËR RITJEN E MASËS SË SHPËRBLIMIT TË VETERANËVE TË LUFTËS ANTIFASHISTE NACIONALÇLIRIMTARE TË POPULLIT SHQIPTAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 8 të ligjit nr.7874, datë 17.11.1994 “Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar”, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së

Shqipërisë” dhe të nenit 7 të ligjit nr.8983, datë 20.12.2002 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2003”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr.190, datë 3.5.1995 të Këshillit të Ministrave “Për zbatimin e ligjit nr.7874, datë 17.11.1994 “Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar”, të bëhen këto ndryshime:

-Pika 7 ndryshohet si më poshtë vijon:

“7.a. Për veteranët që luftuan në formacione luftarake, të çdo rangu, kundër pushtuesve nazifashistë, të inkuadruar përpara datës 10.7.1943, shpërblimi të bëhet 3 092 (tre mijë e nëntëdhjetë e dy) lekë në muaj.

b. Për veteranët që luftuan në formacione luftarake, të çdo rangu, kundër pushtuesve nazifashistë, të inkuadruar në periudhën 11.7.1943 deri në 24.5.1944, shpërblimi të bëhet 2476 (dy mijë e katërqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë në muaj.

c. Për veteranët që luftuan në formacione luftarake, të çdo, rangu kundër pushtuesve nazifashistë, të inkuadruar në periudhën 25.5.1944 deri në 29.11.1944, shpërblimi të bëhet 2 061 (dy mijë e gjashtëdhjetë e një) lekë në muaj.

ç. Për veteranët që luftuan në formacione luftarake, pas datës 29.11.1944 e që vazhduan luftën jashtë kufijve të atdheut, shpërblimi të bëhet 618 (gjashtëqind e tetëmbëdhjetë) lekë në muaj.”.

- Pika 8 ndryshohet si më poshtë vijon:

“8.a. Të burgosurit në burgjet nazifashiste, brenda dhe jashtë vendit, për kohën e burgosjes mbi 6 muaj të marrin një shpërblim prej 1 030 (një mijë e tridhjetë) lekësh në muaj.

b. Të burgosurit në burgjet nazifashiste, brenda dhe jashtë vendit, për kohën e burgosjes deri në 6 muaj të marrin një shpërblim prej 618 (gjashtëqind e tetëmbëdhjetë) lekësh në muaj.”.

- Pika 9 ndryshohet si më poshtë vijon:

“9.a. Të internuarit në kampet e përqëndrimit nazifashist të marrin një shpërblim prej 3 092 (tre mijë e nëntëdhjetë e dy) lekësh në muaj, plus masën e shpërblimit të invalidit të grupit të parë.

b. Të internuarit në kampet e internimit, brenda dhe jashtë vendit, të marrin një shpërblim prej 2 061 (dy mijë e gjashtëdhjetë e një) lekësh në muaj.”.

- Pika 11 ndryshohet si më poshtë vijon:

“11. Veteranët e plagosur në luftë, të cilët nuk përfitojnë statusin e invalidit të luftës, përveç shpërblimit mujor të veteranit, të marrin edhe një shtesë prej 1 030 (një mijë e tridhjetë) lekësh në muaj.”.

- Pika 13 ndryshohet si më poshtë vijon:

“13. Familjeve të veteranëve të vdekur, që përfitojnë këtë status, por që nuk kanë marrë shpërblimin prej 100 (njëqind) lekësh në muaj, t’u jepet një shpërblim i menjëhershëm prej 41 253 (dyzet e një mijë e dyqind e pesëdhjetë e tre) lekësh.”.

2. Institutit të Sigurimeve Shoqërore, në buxhetin e miratuar për vitin 2003, t’i shtohet fondi prej 32 400 000 (tridhjetë e dy milionë e katërqind mijë) lekësh, për mbulimin e shpenzimeve që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi.

3. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

4. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Financave dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.1.2003.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.218, datë 10.4.2003

**PËR KALIMIN NË ADMINISTRIM TË BASHKISË SË QYTETIT PËRMET
TË ISH-SHTËPISË SË USHTARAKËVE NË KËTË QYTET**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 13 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” dhe të neneve 7 e 8, shkronjat “a” e “c” të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Bashkisë së qytetit të Përmetit t’i kalojë në administrim ish-shtëpia e ushtarakëve në këtë qytet, e cila i jepet Qendrës Kulturore të këtij qyteti për ta përdorur si muze të arkeologjisë, etnografisë, kulturës, arsimit dhe figurave të shquara të rrethit të Përmetit.

2. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes të bëjë dorëzimin e kësaj prone të paluajtshme.

3. Bashkisë së qytetit të Përmetit i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përcaktuar në këtë vendim, ta tjetërsojë ose ta japë në përdorim të tjetër.

4. Ngarkohet bashkia e qytetit të Përmetit të përballojë shpenzimet për mirëmbajtjen e pronës së dhënë në administrim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.219, datë 10.4.2003

**PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE
CIVILË, ME ARSIM TË LARTË, NË SPITALIN USHTARAK QENDROR UNIVERSITAR
DHE PËR TRAJTIMIN E MJEKËVE NË STRUKTURAT E FORCAVE TË ARMATOSURA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 e 5 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes dhe të Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit civilë, me arsim të lartë, në Spitalin Ushtarak Qendror Universitar të jenë sipas lidhjes nr.1, (Kreu I.1) të vendimit nr.306, datë 27.6.2002 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave të punonjësve me arsim të lartë në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë”.

2. Mjekët civilë të strukturave të Forcave të Armatosura, të cilët kryejnë specializime, në qendrat spitalore universitare, gjatë kohës së specializimit, të paguhen sipas pikës 8 të vendimit nr.306, datë 27.6.2002 të Këshillit të Ministrave.

3. Mjekëve civilë dhe ushtarakë, të strukturave të Forcave të Armatosura për kryerjen e shërbimit të rojës, të gatishmërisë dhe të urgjencës, në spitale dhe qendra shëndetësore me shtretër, t’u jepet shpërblim, sipas pikës 9 të vendimit nr.306, datë 27.6.2002 të Këshillit të Ministrave. Ministri i Mbrojtjes përcakton kriteret dhe rregullat për dhënien e këtij shpërblimi.

4. Mjekëve civilë dhe ushtarakë, anëtarë të komisioneve mjekoligjore, t’u jepet shpërblim për punën që kryejnë, sipas pikës 10 të vendimit nr.306, datë 27.6.2002 të Këshillit të Ministrave.

5. Punonjësve civilë, me arsim të lartë, në Spitalin Ushtarak Qendror Universitar, t’u jepet një shtesë, për natyrë të veçantë pune, në masën 30 për qind mbi pagën e grupit.

6. Të gjitha dispozitat, që bien në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.
7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2003, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.4.2003.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.220, datë 10.4.2003

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.439, DATË 4.8.2000 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR HYRJEN, QËNDRIMIN DHE TRAJTIMIN E TË HUAJVE NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 83 të ligjit nr.8492, datë 27.5.1999 “Për të huajt”, me propozimin e Ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr.439, datë 4.8.2000 të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, pas pikës 25, shtohet pika 25/1 me këtë përmbajtje:

“25/1. Shtetasit e huaj, që punojnë në organizatat bamirëse e filantropike, në organizatat humanitare, në fondacionet dhe shoqatat fetare, përjashtohen nga pagesa për kartë, lejeqëndrimi dhe lejeqëndrimi në Republikën e Shqipërisë.”.

2. Ngarkohen Ministria e Rendit Publik dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.221, datë 10.4.2003

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.671, DATË 15.12.2000
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT TË PËRCAKTIMIT
TË VERBËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17 të ligjit nr.8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbërit”, me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.671, datë 15.12.2000 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Pika 5 riformulohet si më poshtë vijon:

“5. Pagesa e mjekëve dhe e anëtarëve të tjerë të komisionit të bëhet në bazë të pjesëmarrjes në çdo komision dhe, përkatësisht, për kryetarin e komisionit në masën 23 për qind, ndërsa për anëtarët e komisionit 20 për qind të pagës mujore, sipas strukturës së pagave të përcaktuara në vendimin nr.306, datë 27.6.2002 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të punonjësve me arsim të lartë në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë”, kreu I.1, lidhja nr.1, emërtimi “mjek”, por jo më shumë se një pagë mujore e këtij emërtimi. Komisioni mblidhet jo më shumë se

katër herë në muaj.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e Shërbimit Social Shtetëror.

3. Në të gjitha pikat e vendimit, emërtimi “Administrata e Përgjithshme e Ndihmës dhe Shërbimeve Sociale”, ndryshohet në “Shërbimi Social Shtetëror”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.12, datë 9.4.2003

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu Kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Zija Vuci Anëtar i “““

Alfred Karamuço Anëtar i “““

Kristofor Peçi Anëtar i “““

Kujtim Puto Anëtar i “““

Xhezair Zaganjori Anëtar i “““

Petrit Plloçi Anëtar i “““

Sokol Sadushi Anëtar i “““

Gjergj Sauli Anëtar i “““

me sekretare Arbenka Lalica, në datat 17.1.2003 dhe 30.1.2003, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.250/8 Akti që i përket:

KËRKUES: SERVET, DONIKA E VIRGJINUSH MINAROLLI, si dhe JOSIF

VELO, MERITA EMINAJ, përfaqësuar nga avokatët Arqile Nini e Fatmir Braka, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. KOMISIONI I KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE PRANË QARKUT KORÇË, përfaqësuar nga Dhimitër Pina zv/kryetar, me autorizim.

2. NDËRMARRJA E RRUGË-TROTUARËVE POGRADec, përfaqësuar nga znj. Mangalina Cane, Kryetare e Bashkisë Pogradec, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetuese i vendimeve nr.259, datë 6.7.2001 të Gjykatës së Apelit Korçë dhe nr.940, datë 18.9.2002 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Për shfuqizimin si antikushtetuese të këtyre vendimeve, kërkuesit kanë parashtruar këto shkaqe:

- Gjykata e Apelit Korçë, ka luajtur rolin e ekspertit, në kundërshtim me natyrën e saj si organ gjykimi.

- Gjykata e apelit ka pranuar pa asnjë titull, Kryetaren e Bashkisë Pogradec, në procesin e gjykimit të çështjes.

- Gjykata e apelit ka zhvilluar shqyrtimin e çështjes në mungesë të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, pa e njoftuar atë për ditën e gjykimit.

- Gjykata e Lartë, çështjen duhet ta kalonte për shqyrtim të rregullt gjyqësor, sepse në rekurs janë ngritur probleme ligjore.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Gjergj Sauli, kërkuesit e përfaqësuesit e tyre, përfaqësuesit e

subjekteve të interesuara dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr.37, datë 11.01.2001, ka vendosur pranimin e padisë së ngritur nga kërkuesit kundër subjekteve të interesuara: Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Pogradec, me cilësinë e të paditurit dhe ndërmarrjes komunale rrugë trotuarëve Pogradec, me cilësinë e personit të tretë. Me këtë vendim u ndryshuan vendimet e dhëna nga Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, sepse u deklarua i lirë, për secilin kërkues, trualli që me vendim komisioni ishte quajtur i zënë.

Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr.259, datë 6.7.2001, ka ndryshuar vendimin e mësipërm të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe ka rrëzuar padinë e ngritur nga kërkuesit, duke i quajtur të drejta vendimet e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr.940, datë 18.9.2002, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesit me arsyetimin se në të nuk gjendeshin shkaqe të parashikuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile.

Kërkuesit, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, kanë kërkuar që të shfuqizohet si antikushtetues vendimi i Gjykatës së Apelit Korçë dhe vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, për shkeljen e të drejtës për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 42/1 i Kushtetutës.

Nga shqyrtimi i çështjes në seancë plenare, Gjykata Kushtetuese arriti në përfundimin se kërkesa e paraqitur është e bazuar.

U vërtetua se Gjykata e Apelit Korçë, gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor ka lejuar disa shkelje të rëndësishme procedurale. Ajo ka marrë përsipër rolin e ekspertit duke vlerësuar si të zënë truallin e paditësve në kushtet, kur sipas nenit 135 të Kushtetutës, gjykatat janë organe të pushtetit gjyqësor dhe si të tilla nuk mund të kryejnë detyra jashtë veprimtarisë gjyqësore. Proceduralisht, ekspertët, thirren nga gjykata për sqarimin e fakteve, për të cilat kërkohen njohuri të posaçme. Çështja e përcaktimit të llojit të truallit objekt konflikti është e tillë që gjykata e apelit zgjidhjen e saj nuk duhet ta bënte vetë, por të urdhëronte kryerjen e një ekspertimi të ri.

Gjykata e Apelit Korçë, ka lejuar që të marrë pjesë aktivisht në seancë gjyqësore pa ndonjë titull, Kryetaren e Bashkisë të qytetit Pogradec. Ky veprim përbën shkelje procedurale që vjen ndesh me parimin e parashikuar në nenin 90 të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit: “askush nuk mund të përfaqësojë në një gjykim civil të drejtat e të tjerëve, përveç kur ligji parashikon ndryshe”. Subjektet e interesuara, nuk patën pretendime ligjore për të justifikuar pjesëmarrjen e kryetares së bashkisë në shqyrtimin e çështjes. Edhe vetë ajo nuk paraqiti ndonjë shkak ligjor për pjesëmarrjen e saj në gjykim.

Gjykata e apelit, gjykimin e çështjes e ka zhvilluar në mungesë dhe padijeninë e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave. Kjo shkelje procedurale e pranuar prej palëve nuk ka prekur vetëm interesat ligjore të palës në mungesë, por edhe interesat e kërkuesve në kuptim të nenit 461 të Kodit të Procedurës Civile.

Shkeljet e mësipërme procedurale kanë cenuar parimin kushtetues të kontradiktoritetit dhe të paanësisë në gjykimin e çështjes dhe si të tilla, kanë pasur ndikimin e tyre në dhënien e vendimit prej gjykatës së apelit.

Në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë, kërkuesit kanë pretenduar shkelje procedurale që janë pasqyruar realisht në materialet e dosjes dhe kanë ndikuar në zgjidhjen e çështjes. Duke vendosur mospranimin e rekursit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk u ka dhënë mundësi kërkuesve që të mbrojnë interesat përkatëse në çështjen në gjykim. Në këtë mënyrë, atyre u janë shkelur të drejtat për një proces të rregullt ligjor të parashikuar nga neni 42/1 i Kushtetutës.

Gjykata Kushtetuese duke bërë vlerësimin e të gjitha shkeljeve të konstatuara çmon se si vendimi i gjykatës së apelit ashtu dhe vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë duhen të shfuqizohen si antikushtetues.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së

Shqipërisë”, njëzëri,

V E N D O S I:

- Shfuqizimin si antikushtetuese të vendimeve nr.259, datë 6.7.2001 të Gjykatës së Apelit Korçë dhe nr.940, datë 18.9.2002 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Apelit Korçë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

V E N D I M
Nr.14, datë 15.4.2003

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci Anëtar i ““
Gjergj Sauli Anëtar i ““
Kristofor Peçi Anëtar i ““
Kujtim Puto Anëtar i ““
Xhezair Zaganjori Anëtar i ““
Petril Plloçi Anëtar i ““
Sokol Sadushi Anëtar i ““
Alfred Karamuço Anëtar i ““

me sekretare Arbenka Lalica, në datë 18.3.2003, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.18 Akti që i përket:

KËRKUES: RAMAZAN BARDHI, përfaqësuar nga avokat Edmond Todhe, me prokurë.
SUBJEKT I INTERESUAR: FITNETE BAGANACI, përfaqësuar nga avokat Luan Lala, me deklaram.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetuese i vendimeve nr.1626, datë 28.12.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; nr.333, datë 21.6.2001 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe nr.717, datë 4.7.2002 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin si antikushtetuese të vendimeve të mësipërme:

- Nga gjykatat janë shkelur parimet e gjësë së gjykuar dhe të kontradiktoritetit.
- Gjykatat, duke vendosur për “toka të lira shtetërore”, kanë ndërhyrë në juridiksionin administrativ, duke dëmtuar njëkohësisht interesat e ligjshme të kërkuesit.
- Kolegji Civil, ka mohuar padrejtësisht të drejtën e ankimit dhe të një gjykimi objektiv, duke i konsideruar shkaqet e ngritura në rekurs si jo në përputhje me kërkesat e nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Alfred Karamuço, përfaqësuesit e kërkuesit, të subjektit të interesuar dhe bisedoi çështjen në tërësi

V Ë R E N:

Në konfliktin gjyqësor midis subjektit të interesuar Fitnete Baganaci si paditëse dhe kërkuesit Ramazan Bardhi si i paditur, me objekt njohje pronësie e kthim trualli, Gjykata e Rrethit Gjyqësor

Durrës, me vendimin nr.1626, datë 28.12.2000, ka pranuar padinë. Këtë vendim ka lënë në fuqi Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr.333, datë 21.6.2001. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr.717, datë 4.7.2002, ka vendosur moskalimin e rekursit për shqyrtim gjyqësor.

Gjykata Kushtetuese arrin në përfundim se në këto tre vendime janë lejuar një sërë shkeljesh, të cilat të marra veçmas ashtu edhe në tërësinë e tyre, përbëjnë proces të parregullt gjyqësor në kuptim të kërkesave të nenit 42 pika 1 të Kushtetutës.

1. Kërkuesi Ramazan Bardhi ka fituar pronësinë mbi një sipërfaqe prej 12.687 m2 truall, ku përfshihet edhe sipërfaqja e truallit në konflikt, me vendimin nr.462, datë 7.5.1999 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, i cili është regjistruar edhe në zyrën e regjistrimit të pasurive Durrës.

Me vendimet nr.529, datë 1.7.1994 dhe nr.521, datë 29.12.1996, personit të interesuar i janë njohur si ish-prona 17.770 m2 truall, nga të cilat iu kthyen fizikisht 10.0000 m2, ndërsa 7.770 m2 i kompensoheshin. Më pas, me vendimin nr.154, datë 22.2.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, i është ndryshuar vendimi i komisionit nga kompensim në kthim fizik të sipërfaqes, por pa përcaktuar ekzaktësisht kufijtë e për më tepër kjo pronësi nuk ishte e regjistruar në zyrën e regjistrimit të pasurive.

Megjithëse në këto kushte, personi i interesuar Fitnete Baganacit, për këtë truall, ka ngritur disa herë padi ndaj kërkuesit, fillimisht për anulimin e vendimeve të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, e cila iu rrëzua me arsyetimin se nuk mbështetej në prova. Më pas, po për të njëjtin truall, ngriti padi rivendikimi, në bazë të nenit 296 të Kodit Civil, të cilën ia rrëzoi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin nr.1261, datë 9.12.1999; kurse Gjykata e Apelit Durrës e pushoi gjykimin me arsyetimin se paditësja nuk kishte të drejtë të ngrinte padi ndaj pronarit të truallit.

Pa ndryshuar subjektet, objektin, shkaqet dhe bazën ligjore, personi i interesuar për herë të tretë ngre padi dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin nr.1626, datë 28.12.2000 e pranon atë, vendim që mbetet në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr.333, datë 21.6.2001. Me këtë vendim, ndryshe nga ai i mëparshmi, i cili ishte i formës së prerë, paditësja Fitnete Baganaci legjitimohej të ngrinte padi rivendikimi ndaj pronarit të ligjshëm (ndryshe nga sa arsyetonin vendimet e mëparshme) dhe përfundimisht e detyronte kërkuesin ta njihte si pronare të truallit personin e interesuar. Në rastin e vendimit nr.1626, datë 28.12.2000, krahas problemit të legjitimitetit, gjykatat kanë qenë plotësisht në kushtet e “gjësë së gjykuar” e për pasojë duhej të vendosnin përsëri pushimin e çështjes.

2. Në shqyrtimin gjyqësor të konfliktit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, kërkuesi, me cilësinë e të paditurit, ka paraqitur para gjykatës të ngrejë kundërpadi, ku kërkohej ndryshimi i vendimeve të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, të dhëna në favor të Fitnete Baganacit.

Gjykata e rrethit me vendim të ndërmjetëm të pamotivuar, ka vendosur të mos pranojë paraqitjen e kundërpadisë, duke shkelur nenin 160 të Kodit të Procedurës Civile. Në këtë mënyrë, gjykata ka mohuar ushtrimin e një mjeti procedural të ligjshëm, në mbështetje të të drejtave e interesave të personave të paditur në një proces gjyqësor civil.

3. Në vendimet gjyqësore të atakuara të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës e asaj të Apelit Durrës, ka alogjizëm, sepse ndërsa nga njëra anë pranohet padia e rivendikimit ndaj të paditurit me titull pronësie, nga ana tjetër në pjesën arsyetuese trualli objekt konflikti konsiderohet truall i lirë shtetëror. Duke iu referuar pjesës arsyetuese të vendimeve, Gjykata Kushtetuese konstaton edhe faktin se ato janë të pambështetura në ligj. Të drejtën për të disponuar mbi trojet e lira shtetërore nuk e kanë gjykatat, por Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave e për pasojë gjykatat kanë arsyetuar tej caqeve të juridiksionit të tyre. Nga ana tjetër, nëse objekt shqyrtimi, sipas gjykatave, do të ishin tokat e lira shtetërore, bëhej kusht i domosdoshëm formimi i rregullt i ndërgjyqësisë, duke krijuar kushte që në shqyrtimin e konfliktit të merrte pjesë Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

4. Në rekursin që kërkuesi Ramazan Bardhi ka paraqitur para Gjykatës së Lartë kundër vendimeve të lartpërmendura të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe Gjykatës së Apelit Durrës, janë ngritur një sërë problemesh të rëndësishme të zbatimit të ligjit si ai i gjësë së gjykuar, i mospranimit për shqyrtim të kundërpadisë e i mospranimit të pezullimit të gjykimit. Këto probleme të rëndësishme që kanë të bëjnë me shkelje të rënda të ligjit procedural dhe që gjejnë mbështetje edhe në materialet e çështjes, përbënin bazë të mjaftueshme që Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në mbështetje

të nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile, ta kalonte çështjen për shqyrtim gjyqësor. Përkundrazi, kolegji, me vendimin nr.717, datë 4.7.2002, ka vendosur moskalimin e çështjes në gjyq me arsyetimin se në rekurs mungonin shkaqet e parashikuara nga neni 472 i Kodit të Procedurës Civile.

Një vendim i tillë ka cenuar të drejtën e kërkuarit për një proces të rregullt ligjor, që e bën atë antikushtetues, në vështrim të nenit 42 paragrafi i parë i Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f e 134/g të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, njëzëri,

V E N D O S I:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimeve nr.1626, datë 28.12.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; nr.333, datë 21.6.2001 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe nr.717, datë 4.7.2002 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

- Dërgimin e çështjes Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

V E N D I M Nr.15, datë 17.4.2003

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu Kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Zija Vuci Anëtar i ““““

Gjergj Sauli Anëtar i ““““

Alfred Karamuço Anëtar i ““““

Kujtim Puto Anëtar i ““““

Xhezair Zaganjori Anëtar i ““““

Petrit Pllaçi Anëtar i ““““

Sokol Sadushi Anëtar i ““““

Kristofor Peçi Anëtar i ““““

me sekretare Arbenka Lalica, në datë 26.2.2003, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.16 Akti që i përket:

KËRKUES: KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT, përfaqësuar nga zoti Njazi Jaho, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga zotërinjtë Viktor

Gumi, Ilir Shurdhi e Gëzim Veleshnja, me autorizim.

2. KËSHILLI I MINISTRAVE, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i nenit 410/2 të ligjit nr.7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002.

BAZA LIGJORE: Nenet 31/ç, 42, 131/f të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë; neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27-31 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”

Kërkuar ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin e nenit 410/2 të Kodit të Procedurës Penale:

- Ndryshimi që i është bërë nenit 410/2 të Kodit të Procedurës Penale, ka cenuar të drejtën e individit për një proces të rregullt ligjor, nëpërmjet mohimit të së drejtës për t'u mbrojtur dhe të drejtës për gjykim, të garantuara nga nenet 31/ç, 42 të Kushtetutës, si dhe nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

- Formulimi i mëparshëm i këtij paragrafi në lidhje edhe me nenin 48 të Kodit të Procedurës Penale parashikonte të drejtën e mbrojtësit për të bërë ankim ndaj vendimit të dhënë në mungesë të të gjykuarit edhe në rastet kur akti i përfaqësimit i është dhënë nga të afërmit e të pandehurit, kurse shtesa e bërë ia heq këtë të drejtë.

- Pranimi i shqyrtimit vetëm të rekursit të prokurorit kundër vendimit, pa pranuar ankimin, i vë palët në pozita të pabarabarta duke mos respektuar kërkesat e nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut për "barazinë e armëve".

- Amendimi i nenit 410/2 të Kodit të Procedurës Penale nuk reflekton as jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese (vendimet nr.17/2000 dhe 5/2001) në të cilën është mbajtur një qëndrim krejt i ndryshëm, duke arritur në përfundimin se një praktikë e tillë, cenon të drejtën kushtetuese të mbrojtjes.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kristofor Peçi, përfaqësuesit e kërkuarit, të subjekteve të interesuara dhe bisedoi çështjen në tërësi

V Ë R E N:

Komiteti Shqiptar i Helsinkit është një organizatë e njohur për veprimtarinë e saj në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, i cili sipas statutit, ka si objekt dhe qëllim vëzhgimin e gjendjes lidhur me këto të drejta. Duke patur një qëllim të tillë, ai ka statusin e një kërkuari të legjitimuar, sipas nenit 134 të Kushtetutës.

Në shqyrtimin e kësaj çështje, Gjykata Kushtetuese nisat nga qëllimi që të garantojë realisht të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë dhe si të tilla dhe vendosjen e konsolidimit e një sistemi ligjor të përshtatshëm dhe të aftë për t'i mbrojtur ato nga çdo cenim real apo potencial.

Me këtë rast, ajo vë në dukje se nuk mund të bëhet fjalë për garantim të të drejtave e lirive themelore të individit, nëpërmjet një procesi të rregullt ligjor, kur ky proces bazohet në një akt normativ me përmbajtje antikushtetuese, siç është edhe neni 410/2 i Kodit të Procedurës Penale me plotësimet që i janë bërë me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002 dhe konkretisht me shtesën në të të fjalëve "... nga i pandehuri". Ky plotësim, i cili në vetvete rezultojnë të jetë i panevojshëm, sepse pa të ky paragraf është i kuptueshëm dhe i zbatueshëm në lidhje dhe me dispozitatë të tjera të ligjit, shkel të drejtat e individit për një proces të rregullt ligjor, nëpërmjet të drejtës për t'u mbrojtur dhe të drejtës për gjykim të çështjes në të gjitha shkallët, të garantuara nga nenet 31/ç e 42 të Kushtetutës dhe nenet 6 e 13 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Gjykata Kushtetuese çmon se antikushtetueshmëria në paragrafin e dytë të nenit 410 të Kodit të Procedurës Penale konsiston në disa drejtime, të cilat evidentohen nga krahasimi i përmbajtjes së tij me dispozitatë e Kushtetutës dhe të akteve ndërkombëtare.

1. Shtesa në këtë paragraf vjen në kundërshtim me parimin kushtetues të mbrojtjes në procesin penal. Para këtij ndryshimi, pika 2 e nenit 410 kishte këtë përmbajtje: "Kundër vendimit të dhënë në mungesë, mbrojtësi mund të bëjë ankim vetëm kur është i pajisur me një akt përfaqësimi të lëshuar në format e parashikuara nga ligji". Me plotësimin që i është bërë këtij paragrafi, duke shtuar pas fjalës "lëshuar", fjalët "nga i pandehuri", mohohet e drejta e mbrojtësit për të bërë ankim dhe për të marrë pjesë në gjykim në një shkallë më të lartë po qe se ai nuk është pajisur me akt përfaqësimi të lëshuar nga i pandehuri. Në këtë mënyrë, cenohet e drejta e ankimit dhe e mbrojtjes për vetë të pandehurin, gjë që vjen në kundërshtim me përmbajtjen e nenit 17 të Kushtetutës, sepse kufizimi prek thelbin e së drejtës dhe tejkalon kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut. Prekja e thelbit të së drejtës së ankimit dhe mohimi i saj, konsiston në faktin se i gjykuari në mungesë që i fshihet drejtësisë, është në pamundësi të pajisë mbrojtësin me akt përfaqësimi të lëshuar prej tij në format e parashikuara nga ligji, pra efektivisht të mos ushtrojë të drejtën e ankimit.

Gjykata Kushtetuese, vlerëson se në miratimin e një ligji apo plotësimin e tij nuk duhet të lejohen mospërputhje mes qëllimit që synohet të arrihet dhe masave që shërbejnë për arritjen e tij. Në

rast se ligji synon të sigurojë të drejta, shmangia nga ky qëllim nëpërmjet masave kufizuese tej kriterëve të lejuara, cenon të drejtat në mënyrë të papërligjur. E parë në këtë aspekt, përmbajtja e nenit 410/2 të Kodit të Procedurës Penale ka si qëllim të njohë dhe garantojë të drejtën e ankimit ndaj vendimit gjyqësor të dhënë në mungesë të të akuzuarit. Por, kufizimi që mbrojtësi duhet të jetë i pajisur me akt përfaqësimi të lëshuar vetëm nga i pandehuri, kur ky i fundit nuk është i pranishëm, del jashtë qëllimit të ligjit, duke prekur e mohuar të drejtën e ankimit.

Respektimi i së drejtës së mbrojtjes është një kriter i rëndësishëm që duhet të përmbushë ligji procedural, për t'u konsideruar i pajtueshëm me Kushtetutën. Në kuadrin e konsolidimit të shtetit ligjor, është e domosdoshme që organi ligjvënës të respektojë kriteret të tilla që i japin mundësi të përsosë procesin e miratimit të ligjeve në përputhje me Kushtetutën, duke respektuar të drejtat dhe liritë themelore të individit. Procesi i transformimit të sistemit të mëparshëm ligjor në një të ri dhe i përsosjes së tij në konformitet me Kushtetutën, kërkon që jo vetëm të ekskludohen prej tij norma që vijnë ndesh me parimet kushtetuese, por edhe të afirmohen ato parime të njohura që mbrojnë të drejtat dhe liritë themelore. Garantimi i së drejtës për një ankim efektiv nga Kushtetuta dhe Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe nga akte të tjera ndërkombëtare shtrun para organit ligjvënës detyrën që jo vetëm të mos e pengojë individin të ushtrojë një të drejtë të tillë, por t'i sigurojë atij mjetet e nevojshme për ushtrimin efektiv të saj.

Në nenin 8 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, si dhe në nenin 13 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, parashikohet e drejta e rekursit efektiv ndaj vendimit të gjykatës. Kurse në nenin 2 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile e Politike, përcaktohet për shtetet detyrimi që të garantojnë nëpërmjet organeve kompetente gjyqësore, administrative ose legjislative të drejtën e individit për të ushtruar rekurs, si dhe krijimin e mundësive për gjykimin e këtij rekursi.

Sipas praktikës së Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, në zbatim të nenit 6 të Konventës, lejohen që shtetet palë të kenë një kufi vlerësimi të caktuar për të bërë kufizime të të drejtave, por me kusht që kufizimi të mos e reduktojë të drejtën në mënyrë dhe masë të tillë që të preket thelbi i saj (në këtë mënyrë shprehet dhe nenit 17 i Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë), të ndiqet kurdoherë një qëllim i ligjshëm për interes publik dhe të mos ketë disproporcion të paarsyeshëm midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet.

Kufizimi i bërë në nenin 410/2 të Kodit të Procedurës Penale, nuk përmbush asnjë nga këto kërkesa të rëndësishme, por bie haptazi në kundërshtim me to.

Me ndryshimin që i është bërë nenit 410/2 të Kodit të Procedurës Penale, Gjykata Kushtetuese, thekson se çdo përpjekje e gjykatave të sistemit gjyqësor për të zhvilluar një proces të rregullt ligjor dhe respektuar të drejtën e ankimit dhe të mbrojtjes, do të ishte pa asnjë efekt, nëqoftëse ligji ku mbështeten vendimet e tyre nuk lejon ushtrimin e një të drejte të tillë. Si rrjedhojë ai ka përmbajtje antikushtetuese. Në zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, rëndësi vendimtare ka saktësia dhe drejtësia e ligjeve materiale e procedurale në të cilat mbështetet gjykata për të shqyrtuar dhe zgjidhur çështjen.

Neni 410/2 i Kodit të Procedurës Penale e cenon të drejtën e mbrojtjes edhe në një drejtim tjetër, në atë të shkeljes së parimit të barazisë së palëve dhe të kontradiktoritetit në gjykim, gjë që vjen në kundërshtim me parimet kushtetuese dhe praktikën e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, për respektimin e kërkesave për “barazinë e armëve”, që secilës palë t'i sigurohen mundësitë përkatëse për të parashtruar pretendimet e saj në kushte që nuk e vënë atë në gjendje më pak të favorshme se palën tjetër. Moslejimi i mbrojtësit për të bërë ankim ndaj vendimit të gjykatës, të dhënë në mungesë të të akuzuarit, në kushtet e nenit 410/2 të Kodit të Procedurës Penale, e vë njërën palë në pozitë të pabarabartë me palën tjetër.

Gjykata Kushtetuese vlerëson se për të siguruar zbatimin e drejtë të parimit të barazisë, organi ligjvënës duhet të udhëhiqet nga rregulla të tilla përcaktuese që në kushte të njëjta, të bëjë rregullime ligjore në mënyrë të tillë që të përjashtojë arbitraritetin dhe trajtimin favorizues të një pale në dëm të palës tjetër. Parimi i barazisë para ligjit duhet kuptuar jo vetëm si përjashtim i arbitraritetit në zbatimin e tij, por në radhë të parë, në miratimin e ligjeve me përmbajtje të tillë që të shmangin pabarazinë.

Nga ana tjetër, për t'i qëndruar konsekuent ndryshimit të bërë në paragrafin e dytë të nenit 410 të Kodit të Procedurës Penale, organi ligjvënës duhet të harmonizonte me të edhe pikën 3 të nenit 48 të këtij Kodi, sipas të cilës, zgjedhja e mbrojtësit për personin e ndaluar, të arrestuar ose të dënuar me burgim, derisa ky person nuk e ka bërë vetë zgjedhjen, mund të bëhet nga një i afërm i tij në format e parashikuara në paragrafin e dytë të këtij neni. Po të bëhet krahasimi i përmbajtjes së këtyre neneve të

të njëjtit ligj, del se sipas nenit 48, mbrojtësi mund të caktohet jo vetëm nga i pandehuri, por edhe nga të afërmit e tij, por për të bërë ankim ndaj vendimit të dhënë në mungesë të të pandehurit, sipas nenit 410/2, kërkohet akti i përfaqësimit i lëshuar nga ky i fundit. Caktimi i mbrojtësit në procesin penal në kushtet dhe mënyrat e parashikuara në ligj, përfshirë dhe atë të caktuar kryesisht nga gjykata, nuk ka për qëllim vetëm pjesëmarrjen e tij në një shkallë të gjykimit, por ndjekjen e çështjes nëpërmjet ushtrimit të së drejtës së ankimit dhe pjesëmarrjes në të, deri në instancën më të lartë gjyqësore, për të mbrojtur plotësisht të drejtat e të pandehurit në një proces të rregullt ligjor. Duke pasur caktimi i mbrojtësit këtë qëllim ligjor e kushtetues, del se përmbajtja e nenit 410/2 vjen ndesh me të e për rrjedhojë, ka karakter antikushtetues.

Në vijim të argumenteve për shkelje të parimeve të së drejtës së mbrojtjes që rezultojnë nga përmbajtja e nenit 410/2 të Kodit të Procedurës Penale, Gjykata Kushtetuese thekson se e drejta e mbrojtjes me avokat si garanci kushtetuese duhet të jetë efektive. Që kjo e drejtë të jetë jo thjesht teorike, por praktike dhe efektive, ushtrimi i saj nuk duhet bërë duke plotësuar kushte formale e të panevojshme, por kushte të përshtatshme me kërkesat e një gjykimi të drejtë, nisur nga qëllimi i dukshëm për mbrojtjen e të akuzuarit në mungesë. Në të kundërt, përdorimi i kriterëve procedurale, duke shkelur parimin e proporcionalitetit dhe të barazisë së palëve, kombinuar edhe me rrezikun imediat të ndëshkimit penal pa u kondicionuar me zbatimin e parimit të kontradiktoritetit, krijon në vetvete një situatë arbitrariteti që mund të çojë edhe në dënim të padrejtë. Gjykata Kushtetuese është e mendimit se parimi i proporcionalitetit duhet të merret në konsideratë edhe nga pikëpamja e rrezikut që mund të krijojë për gjykimin e çështjes në mënyrë të njëanshme dhe dhënien e dënimit të padrejtë. Kjo gjë jo vetëm do të shkelte të drejtat e individit, por do të cenonte edhe bazat e shtetit ligjor.

2. Ndryshimi i pikës 2 të nenit 410 të Kodit të Procedurës Penale bëhet nga Kuvendi, pasi Gjykata Kushtetuese me vendimet e saj nr.17, datë 17.04.2000 dhe nr.5, datë 7.2.2001, ka shfuqizuar si antikushtetuese dy vendime të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, përkatësisht atë me nr.386, datë 29.7.1999 dhe nr.371, datë 21.10.2000, për shkak të procesit të parregullt ligjor dhe shkelje të parimeve kushtetuese që garantojnë liritë dhe të drejtat e individit.

Në vendimin nr.17, datë 17.4.2000, Gjykata Kushtetuese arsyeton ndër të tjera se Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë interpretuar gabim ligjin duke shkelur një të drejtë themelore dhe kanë zhvilluar një proces të parregullt gjyqësor. Në vendim arsyetohet gjithashtu: "... Mbrojtësi i të pandehurit që gjykohet në mungesë, i caktuar sipas kërkesave të ligjit, gëzon të gjitha të drejtat e mbrojtësit në një mbrojtje të detyrueshme, përfshirë dhe të drejtën e ankimit ndaj vendimit të gjykatës...".

Në këtë vendim, Gjykata Kushtetuese, sqaron se interpretimi i ngushtë i nenit 410/2 të bërë nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke kufizuar të drejtën e mbrojtjes për të bërë ankim ndaj vendimit të dhënë në mungesë të të gjykuarit, bie ndesh me parimet kushtetuese dhe nenin 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe të praktikës së Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, që kërkojnë një interpretim sa më të gjerë të parimeve të së drejtës së mbrojtjes dhe të procesit të rregullt ligjor.

Në vendimin tjetër me nr.5, datë 7.2.2001, Gjykata Kushtetuese, duke bërë një interpretim përfundimtar të ligjit lidhur me të drejtën e mbrojtjes në frymën e Kushtetutës dhe të akteve ndërkombëtare shprehet: "... Vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë fuqi detyruese të përgjithshme. Ato përbëjnë jurisprudencën kushtetuese dhe për rrjedhojë, kanë efektet e formës së prerë...". Më tej në këtë vendim arsyetohet se asnjë organ tjetër nuk ka të drejtë të vejë në diskutim vendimet e Gjykatës Kushtetuese dhe aq më tepër të mos pranojë t'i zbatojë ato, gjë që do të bënte një precedent të rrezikshëm për t'i mohuar këtij organi funksionin e garantimit të Kushtetutës. Gjithashtu, duke mbështetur qëndrimin e mbajtur në vendimin e mëparshëm për të drejtën e mbrojtësit, të caktuar nga të afërmit e të pandehurit për të bërë ankim ndaj vendimit të gjykatës sipas neneve 48 e 410/2 të Kodit të Procedurës Penale, në vendim theksohet se në këtë rast, nuk është bërë një interpretim i thjeshtë i ligjit "por është arritur që të rikonfirmohet, nëpërmjet interpretimit kushtetues, një parim thelbësor që përbën garanci kushtetuese".

Nga paraqitja shkurtimisht e argumenteve të këtyre vendimeve del qartë se Gjykata Kushtetuese duke interpretuar përmbajtjen e neneve 410/2 e 48 të Kodit të Procedurës Penale, në përputhje me Kushtetutën, Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe akte të tjera ndërkombëtare, u ka dhënë këtyre dispozitave një kuptim të caktuar në mënyrë që me zbatimin e tyre të sigurohet mbrojtja e të drejtave themelore.

Pikërisht këto vendime të Gjykatës Kushtetuese, të cilat janë përfundimtare, të formës së prerë dhe të detyrueshme për zbatim, nuk janë mbajtur parasysh nga Kuvendi me rastin e ndryshimit që i ka bërë nenit 410/2 të Kodit të Procedurës Penale. Natyrisht, që Kuvendi, si organ ligjvënës, ka kompetencën dhe vullnetin e lirë të bëjë ndryshime e plotësime në ligj, por me kusht që ato të mos vijnë ndesh me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese, në përgjithësi dhe ato të cituara më lart në veçanti, janë mbështetur në Kushtetutë dhe në marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, prandaj Kuvendi nuk duhej të vepronte në kundërshtim me to.

Në rast se organi ligjvënës e konsideronte të paplotë ose të paqartë përmbajtjen e nenit 410/2 dhe ishte i mendimit se ajo duhej sqaruar më tej për të siguruar një zbatim të drejtë e unik, duhej të tregonte kujdesin e duhur që ndryshimet të prireshin nga gjetja e mjeteve e mënyrave për t'i garantuar të akuzuarit që gjykohej në mungesë, të drejtën e ankimit dhe atë të mbrojtjes.

Gjykata Kushtetuese, në përfundim të kësaj analize siç u parashtrua më lart, duke marrë në konsideratë parimet dhe faktorët e rëndësishëm që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të cilat bashkë me parime të tjera të rëndësishme kushtetuese, përbëjnë sipas nenit 3 të Kushtetutës, bazën e shtetit, që ky i fundit ka për detyrë t'i respektojë dhe t'i mbrojë, thekson se shfuqizimi i shprehjes së përmendur në objektin e kërkesës që vjen ndesh me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, përbën një detyrë imperative për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe forcimin e shtetit ligjor. Meqënëse me këtë shfuqizim nuk krijohet boshllëk ligjor, nuk lind nevoja që organi ligjvënës të bëjë ndonjë plotësim.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131/a e 134/f të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e 76 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, me shumicë votash

V E N D O S I:

Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare në nenin 410 paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Penale, të fjalëve "nga i pandehuri".

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

MENDIMI I PAKICËS

1. Nuk jemi të një mendimi me shumicën lidhur me shfuqizimin si jokushtetuese të shtesës që i është bërë pikës 2 të nenit 410 të Kodit të Procedurës Penale me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002, "Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.7905, datë 21.03.1995, "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë" e konkretisht të fjalëve "nga i pandehuri", që përmban ky nen. Me këtë shtesë pika 2 e nenit 410 ka këtë përmbajtje: Kundër vendimit të dhënë në mungesë, mbrojtësi mund të bëjë ankim vetëm kur është i pajisur me një akt përfaqësimi të lëshuar nga i pandehuri në format e parashikuara nga ligji.

Pala kërkuese, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, ka kërkuar që të shfuqizohet si jokushtetuese shtesa e mësipërme, duke pretenduar se me këtë ndryshim të bërë, cenohet e drejta e mbrojtjes.

Ne mendojmë se dispozita e kundërshtuar si më parë, ashtu edhe me shtesën e bërë me ligjin e vitit 2002 është në pajtim me Kushtetutën.

2. Rasti i paraqitur për shqyrtim ka në qendër të tij të drejtën e ankimit të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, një e drejtë kjo themelore e individit, e parashikuar në nenin 43 të Kushtetutës, dhe më konkretisht, nëse ka të drejtë mbrojtësi, të kundërshtojë vendimin e dënimit të marrë në mungesë të të pandehurit, pa qenë i pajisur prej këtij të fundit me akt përfaqësimi për të ankimuar këtë vendim. Sipas kësaj dispozite të Kushtetutës, "Kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveçse kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe". Kjo e drejtë ka gjetur rregullim edhe në pikën 1 të nenit 2 të protokollit nr.7 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Sipas pikës 1 të kësaj dispozite të protokollit “Çdo person i deklaruar fajtor për një vepër penale nga një gjykatë ka të drejtë të paraqesë për shqyrtim përpara një gjykate më të lartë deklarimin e fajësisë ose dënimit. Ushtrimi i kësaj të drejte, duke përfshirë shkaqet për të cilat ajo mund të ushtrohet, përcaktohen me ligj”.

Nga këto formulime konstatohet se e drejta e ankimit, në kontekstin kushtetues, është një e drejtë individuale. Kjo e drejtë kushtetuese e individit, në kontekstin procedural penal, është një e drejtë që i përket vetëm të pandehurit (të akuzuarit) dhe askujt tjetër.

Edhe në rastin e gjykimit në mungesë të të pandehurit, është ky i fundit që duhet të vendosë nëse duhet t’a ankimojë ose jo vendimin e dënimit të tij të dhënë nga gjykata e shkallës së parë. Pranimi ose jo i vendimit të dënimit është me rrjedhoja të dukshme për të pandehurin dhe nuk mund të lihet në diskrecionin e mbrojtësit.

Pikërisht, në këtë linjë e ka rregulluar edhe Kodi i Procedurës Penale të drejtën e ankimit të të pandehurit, duke e konsideruar këtë të drejtë si të tillë që i përket vetëm këtij të fundit. Një qëndrim i tillë del qartë nga formulimi i neneve 50/1, 407/4 e 410/1/2 të Kodit të Procedurës Penale. Kështu, sipas nenit 50 të këtij Kodi, në të cilin rregullohet “shtrirja e të drejtave të të pandehurit të mbrojtësi”, “mbrojtësi ka të drejtat që ligji i njeh të pandehurit, përveç atyre që i rezervohen personalisht këtij të fundit”. Sipas nenit 407/4, në të cilin rregullohen “rastet dhe mjetet e ankimit”, “e drejta e ankimit i takon vetëm atij që ligji ia njeh shprehimisht”, kurse sipas nenit 410, në të cilin rregullohet “ankimi i të pandehurit”, “1.I pandehuri mund të bëjë ankim vetë ose nëpërmjet mbrojtësit të tij. Kujdestari i të pandehurit mund të bëjë çdo ankim që i takon të pandehurit. 2. Kundër vendimit të dhënë në mungesë, mbrojtësi mund të bëjë ankim vetëm kur është i pajisur me një akt përfaqësimi të lëshuar nga i pandehuri në format e parashikuara nga ligji”. Po kështu, sipas nenit 422, me titull “E drejta e apelit”, “Prokurori, i pandehuri dhe palët private mund të apelojnë vendimet e gjykatës së shkallës së parë”. Për pasojë, këto dispozita, duke konkretizuar karakterin individual të së drejtës së ankimit, janë në pajtim me Kushtetutën.

Parë në këtë këndvështrimin kushtetues, mendojmë se në rastet kur në gjykimin në shkallë të parë, është proceduar në mungesë të të pandehurit (akuzuarit), as mbrojtësi i zgjedhur nga familjarët e tij, në aplikim të nenit 48/3 të Kodit të Procedurës Penale dhe as mbrojtësi i caktuar nga organi procedues në aplikim të nenit 49/1 të po këtij Kodi (me përjashtim të kujdestarit të të miturit), nuk legjitimohen të apelojnë vendimin e dhënë në mungesë të tij.

E drejta për të qenë i pranishëm në gjyq, e parashikuar në nenin 33 të Kushtetutës, në kontekstin procedural penal, është një e drejtë e të akuzuarit, por sipas pikës 2 të po kësaj dispozite nga kjo e drejtë nuk mund të përfitojë personi që i fshihet drejtësisë. Në këtë vështrim, konstatohet se kjo e drejtë e të akuzuarit nuk është absolute, por përmban në vetvete mundësinë e kufizimit të kësaj të drejte. Mirëpo, ky kufizim i bërë me ligj, duke përmbushur kriteret e kërkuara në nenin 17 të Kushtetutës, përfshihet në kategorinë e kufizimeve të lejueshme në aspektin kushtetues. Në të kundërt, për të drejtën e ankimit Kushtetuta nuk parashikon ndonjë kufizim të tillë. Për më tepër, sipas nenit 175 të Kushtetutës, kjo e drejtë nuk mund të kufizohet as gjatë gjendjes së luftës, gjatë gjendjes së jashtëzakonshme dhe as gjatë gjendjes së fatkeqësisë natyrore. Edhe sipas Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut kjo e drejtë përfshihet në kuadrin e të drejtave që nuk mund të kufizohen.

Lidhur me të drejtën për të qenë i pranishëm dhe për t’u dëgjuar në gjykim, megjithëse kjo e drejtë mund të kufizohet, në kontekst të garantimit të një procesi të rregullt ligjor, i akuzuari në mungesë, duhet të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur nga familjarët e tij ose i caktuar nga organi procedues. Në rastin në shqyrtim kuadri procedural në fuqi e garanton plotësimin e këtij standardi të kërkuar. Megjithëkëtë, kjo nuk nënkupton që mbrojtësi i caktuar duhet të legjitimohet të ankimojë në shkallë të dytë vendimin e marrë në mungesë. Faktimi i këtij mbrojtësi nuk është rezultat i shprehjes së vullnetit të të akuzuarit në mungesë. Pra, në qoftë se mungesa e të akuzuarit në gjykimin e shkallës së parë, në përmbushje të standardeve minimum për një proces të rregullt ligjor, imponon pjesëmarrjen në këtë gjykim të mbrojtësit të caktuar nga familjarët e tij ose kryesisht, kjo nuk nënkupton që ky mbrojtës ka të drejtë të ankimojë vendimin e dënimit të të gjykuarit në mungesë, sepse kjo është një e drejtë kushtetuese individuale e të akuzuarit.

Gjykimi në mungesë i të akuzuarit, i lejuar nga Kushtetuta (neni 33ç 2), është një zgjedhje midis interesit publik, në këtë rast ndëshkimi i krimit, dhe interesit individual, që është garantimi i të drejtave të të akuzuarit në procesin penal. Në rastin në shqyrtim ky konflikt interesash është zgjidhur në favor të interesit publik, por nga ana tjetër janë bërë përpjekje për të siguruar standardet minimum

të të drejtave individuale në procesin penal.

Në këtë vështrim, ne mendojmë se, megjithëse e drejta për të qenë i pranishëm në gjyq nuk është absolute, kjo e drejtë mund të kufizohet në gjykimin në shkallë të parë, ose në një shkallë tjetër gjykimi, humbja e plotë dhe e pariparueshme e saj, nuk mund të justifikohet. Nën dritën e Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe të praktikës së Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, është e domosdoshme që të dënuarit në mungesë për një vepër penale, sapo të vihet në dijeni të dënimit të tij, duhet t'i jepet mundësia të kërkojë anulimin në një gjykim të dytë fakti të vendimit të dënimit të tij, nëpërmjet ankimit apo rivendosjes në afat të ankimit.

3. Në vështrim sa më sipër, ne mendojmë se nuk është i bazuar qëndrimi i shprehur nga shumica në vendim se, me shtesën e bërë në Kodin e Procedurës Penale, cenohet parimi i mbrojtjes në procesin penal. Megjithëse në aspektin kushtetues mbrojtësi i caktuar nuk legjitimohet të paraqesë ankim në gjykatën e shkallës së dytë, në rast se çështja shqyrtohet në këtë gjykatë e vënë në lëvizje mbi ankimin e palës së akuzës, në këtë gjykim në shkallë të dytë, duhet të sigurohet pjesëmarrja e këtij mbrojtësi. Një gjë e tillë përbën një nga standardet për një proces të rregullt ligjor si një e drejtë kushtetuese e individit. Përveç kësaj, edhe qëndrimi i shprehur se dispozita e kundërshtuar cenon parimin e barazisë së armëve, nuk na duket i drejtë. Moslegjitimimi i mbrojtësit të caktuar nuk nënkupton që i gjykuari në mungesë nuk e gëzon një të drejtë të tillë. Përkundrazi, ne mendojmë që në momentin kur i gjykuari në mungesë vjen në dijeni të vendimit të dënimit të tij, atij duhet t'i garantohet mundësia për të kërkuar një gjykim të dytë fakti. Ndërsa, në rastet kur janë konsumuar shkallët e gjykimit me nismën e prokurorit, i gjykuari në mungesë, kur arrestohet në ekzekutim të vendimit të dënimit të tij, ka mundësi që në aplikim të neneve 449 e vijuesa të Kodit të Procedurës Penale, të kërkojë rishikimin e vendimit të dhënë kundër tij. Ne mendojmë se, në këtë mënyrë, e drejta e mbrojtjes dhe e drejta e ankimit në veçanti, si të drejta individuale të të akuzuarit në procesin penal, do të bëhen praktike dhe efektive.

Anëtarë: P. Plloci, K. Puto

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

Kodi Penal <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Mars, 2002	Kodi i Procedurës Penale <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Shtator, 2002	Kodi i Procedurës Civile <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Korrik, 2002	Kodi Rrugor <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Qershor, 2002
Kodi Penal Ushtarak <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002	Përmbledhëse legjislacioni në fushën e Përmbardimit <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002		

U dorëzua për shtyp më 22.4.2003

Doli nga shtypi më 22.4.2003

Tirazhi: 4300 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2003

Çmimi: 150 lekë